



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Podujevë, tetor 2023

## Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

### Për Takimet e Kulturës "Kadri Kadriu" 2023

*SHPALL*

## KONKURS LETRAR

Për

## POEZI, ESE dhe TREGIM TË SHKURTËR

Takimet e kulturës "Kadri Kadriu" janë takime tradicionale të cilat mbahen edhe në këtë vit në Podujevë, mbahet edicioni i 41-të i ketyre takimeve, andaj inkurajohen krijuesit letrarë nga të gjitha trevat shqiptare që me poezitë, esetë dhe tregimet e shkurtëra të bëhen pjesë e këtij takimi letrar.

### Qellimi i konkursit

- Ruajtja, kultivimi dhe zhvillimi i traditës kulturore;
- Nxitja, motivimi dhe promovimi i krijuesve shqiptarë.

### Kushtet për pjesëmarrje

- Poezitë, esetë dhe tregimi i shkurtër që konkurojnë duhet të jenë origjinale, çdo plagjiaturë do të përjashtohet;
- Esetë dhe tregimi i shkurtër nuk duhet të jenë më të gjata se 56 vargje. Temë e lirë.
- Punimet të jenë të punuara në: Microsoft Word, formati i shkronjave: Time New Roman, 12 (në tre kopje);
- Poezitë, esetë dhe tregimi i shkurtër të jenë në gjuhën shqipe, të pabotuara më parë;
- Punimet ME SHIFËR duhet të dorëzohen në Komunën e Podujevës, në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, nr. 10, në zarfe të mbyllura;
- Afati i fundit për dorëzimin e tyre është 20 tetor;
- Punimet e konkursit do t'i vlersoj juria profesionale.

### **Vërejtje:**

Poezitë e arritura do të grumbullohen në dosje, pa të dhëna për autorët por vetëm me shifër. Punimet e paraqitura në konkurs do të vleresohen nga juria profesionale e cila do të bëjë leximin dhe vlerësimin e poezive, pa pasur dijeni mbi autorët, por vetëm në bazë të shifres. Juria do të permbyllë procesin e vlerësimit para datës së mbajtjes së takimit, ndërsa ndarja e çmimeve do të bëhet në ditën e mbajtjes së Manifestimit.

Çmimi "Afrim Maliqi", përzgjidhet nga juria në ORËN E MADHE LETRARE. Pjesëmarrësit që do të marrin pjesë në ORËN LETRARE do të konkurojnë për çmimin "Afrim Maliqi".

### **Vërejtje:**

Krijuesit që duan të marrin pjesë në orën letrare, duhet t'i dërgojnë krijimet e tyre në emailin [dkrs.podujeva@rks-gov.net](mailto:dkrs.podujeva@rks-gov.net), të cilat do t'i nënshtrohen fazës së parë të vlerësimit nga juria për t'u kualifikuar në garën finale, e cila zhvillohet në Orën Letrare. Afati për dërgimin e tyre është deri më datën 25 tetor 2023, pas të cilës datë nuk mund të marrin pjesë në orën letrare.

### **Në këtë takim letrar do të ndahen këto çmime**

Vendi – I - 500 euro

Vendi - II – 300 euro

Vendi – III - 200 euro

Çmimi "Afrim Maliqi" - 500 euro

Si dhe 5(pesë) çmime "**Inkurajuese**" me nga 50 euro, për poetë të rinj në moshë që marrin pjesë për herë të parë në këtë takim.

ORA E MADHE LETRARE MBAHET ME: **15 nëntor 2023**, NE ORa: **18:00**, NE OBJEKTIN E GALERISË SË ARTEVE NË PODUJEVË.

